



KOMUNA E RAHOVECIT

RAPORT VJETOR I PUNËS 2023 DSHPS

**DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE
PËRKUJDESJE SOCIALE**

JANAR - Dhjetor 2023



RAPORT VJETOR I PUNËS 2023 DSHPS

-VI- Nr. i prot. 10 Më 09.01.2024
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

DATË /A:	04.12.2023
REFERENC-Ë:	Raport vjetor i punës
PËR/ZA/TO:	z. Smajl Latifi - Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	znj. Saranda Sallteku – Drejtoreshë e DSHPS - së
LËNDA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport vjetor i punës

HYRJE

Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, gjatë periudhës raportuese janar – Dhjetor 2023, ka zhvilluar aktivitetet e saj në të gjitha fushat e veprimtarisë, me qëllim të rritjes së cilësisë të shërbimeve të kujdesit shëndetësor si dhe ngritjes së përgjithshme të cilësisë së jetës së qytetarëve të Komunës, përfshirë këtu edhe mbështetjen në fushat e shërbimeve sociale dhe më gjerë.

Fushë veprimtaria e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale është e bazuar në aktet normative në fuqi dhe në Planin e Punës për vitin 2023, ky raport përfshin në mënyrë gjithpërfshirëse shërbimet e ofruara në fushën e kujdesit parësor shëndetësor si dhe atë të veprimtarisë sociale, të arriturat dhe vështirësitë e hasura gjatë kësaj periudhe kohore.

AKTIVITETET

- DSHPS qysh në fillim të vitit 2023 ka zhvilluar aktivitete të shumta, në kuadër të përgjegjësi të përshkuara, kemi realizuar gjithë aktivitetet e planifikuara, janë mbështetur projektet në të gjitha fushat e veprimtarisë shëndetësi dhe mirëqenie sociale;
- Angazhimi rreth përmirësimit të kushteve për punë të nëpunësve dhe stafit në përgjithësi në kuadër të DSHPS-së;
- Është bërë shqyrtimi dhe përgjigjja me kohë në kërkesat e ndryshme të qytetarëve, kryesisht për ndihma momentale.
- Edhe gjatë kësaj periudhe raportuese ka vazhduar ofrimi i shërbimeve mjekësore në dy ndërrime në dy QMF-të, në Krushë të Madhe dhe Ratkoc, shërbimet mjekësore me dy ndërrime tanimë janë të përhershme, përirimi i objektit të AMF-së, ne lagjen nr.3,

RAPORT VJETOR I PUNËS 2023 DSHPS

Ecuria e realizimit të projekteve kapitale

- Është bërë përrurimi i Objektit të vjetër të QKMF – së në Rahovec;
- Jemi paisur me dy Auto Ambulanca për nevojat e QKMF-së.
- Vazhdon furnizimi me barna nga lista esenciale nga buxheti i komunes.
- Nga donacion është pais me mjete laboratorike laboratory ne QMF ne Krushe te Madhe
- Kemi pranuar një donacion nga mërgimtarët paisje mjekësore për nevojat e QKMF-së, në vler prej 200,000.00euro.
- Është bërë përrurimi i objektit të ri të AMF-së, në lagje të eperme, lagja nr.3
- Është bërë Dezinfektimi i objekteve shëndetësore, të të gjitha objekteve shkollore, si dhe hapsirave publike.
- Vazhdonjë punimet në renovim të objektit të vjetër të QKMF-së, fasadimi I jashtëm i objektit.
- Ka filluar renovimi i të gjitha objekteve të QMF-ve, dhe AMF-ve.
- Kemi fituar donacion veturen per vizitat shtepiajke, donacion nga ministria e shendetesise

Mirëqenia Sociale:

Në kuadër të aktiviteteve nga fusha e mirëqenies sociale janë zhvilluar aktivitetet e parapara nga kjo fushëveprimtari, sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi. Komisionet kanë punuar vazhdimisht në terren për evidentimin e familjeve në kushte të rënda sociale, dhe këto nevoja janë adresuar vazhdimisht në Qeverinë e Kosovës, donatorë vendor dhe të huaj, janë kontaktuar shoqata të ndryshme dhe OJQ vendore dhe ndërkombëtare, është intervenuar në të gjitha rastet që është krijuar mundësia. Qendra për Punë Sociale dhe Organi i Kujdestarisë në kuadër të saj, si organ komunal profesional kompetent për çështje sociale, përgjegjës për mbrojtjen e interesave të fëmijëve dhe të rriturve, i përbërë nga një grup ekspertësh, ka ndërmarrë të gjitha veprimet për ofrimin e ndihmës për personat në nevojë sociale, sipas procedurave të caktuara, në përputhje me mandatin ligjor.

PËRFUNDIM

Ky raport vjetor paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe:

Me respekt!

